



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:082076

Datë: 28.05.2019

Numri i dokumentit: 00332270

PKR.nr.46/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit H. H. nga fshati Remnik, Komuna e Vitisë, të cilin sipas autorizimit e mbron Av. Afrim Salihu nga Gjilani, për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK-s), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr. 56/2019 të datës 28 mars të vitit 2019, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Mr.sc. Isuf Sadiku, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 27 maj të vitit 2019, nxjerr dhe në prani të prokurorit të shtetit dhe të të pandehurit me mbrojtësin e tij, në të njëjtën ditë, kur edhe e përpilon, publikisht shpall këtë,

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri H. H. nga I ati Hysen dhe e ëma – me mbiemër të vajzërisëi, I lindur më 05.06 1977 në fshatin Remnik, Komuna e Vitisë, ku edhe e ka vendbanimin, posedues I telefonit mobil me SIM kartele, shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës, I martuar, baba I katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, I papunësuar, me gjendje të varfër ekonomike, I pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore,

Ë s h t ë f a j t o r

sepse më datën 22.03 2019, rreth ores 11:30 minuta, në rrugën Gjilan – Ferizaj, afër rrugës së fshatit Zhegër, në parkingun e restorantit “ COMETA”, në veturën e markës AUDI A8, me tabela të regjistrimit 650-KS-150, gjatë një bastisje nga zyrtarët policor është gjetur arma e markës Walter AG-5687-PPS, me 5 fishekë të kalibrit 9 mm, të cilën e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët,

- ashtu që me veprimet e tilla ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s,

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara si dhe nenit 4, 7, 21 dhe 23, nenit 41, 46, 73 – 75 paragrafi 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 365 lidhur me 248 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s), të akuzuarit në fjalë,

I SHQIPTON

DËNIM ME GJOBË në shumën prej **katërqind (400) Euro**, të cilën shumë detyrohet i pandehuri që ta paguaj në dy këste të barabarta prej nga 200 Euro, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të pranuar nga i pandehuri,

Mirëpo në kuptim të nenit 46 paragrafi 2 të KPRK-s nëse i pandehuri nuk mund ose nuk don të përmbush dënimin me gjobë, atëherë ky dënim,

i zëvendësohet

me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzetë (20) ditëve të cilin dënim duhet filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve, duke filluar nga dita e dërgimit përkatësisht pranimit të ftesës për ta mbajtur dënimin me burgim, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Të pandehurit në fjalë në kuptim të nenit 69 të KPRK-s lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s **i shqiptohet**

DËNIMI PLOTËSUES duke ju konfiskuar arma e zjarrtë – revolva e markës AG-5687-PPS me pesë (5) fishekë të kalibrit 9mm me karikator, e cila është sekuestruar nga zyrtari policor me DI 4466 sipas vërtetimit për sekuestrim më datën 22.03 2019 sipas rastit policor 2019-CP-12, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohen përmes komisionit të formuar nga kryetari I kësaj gjykate me proceverbal përkatës, i cili duhet t'i bashkëngjitet kësaj lënde penale, poqese konform dispozitave të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale nuk vendoset ndryshe nga ky komision i autorizuar gjatë ekzekutimit të këtij dënimi plotësues.

III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **tridhjetëpesë (35) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej pesëdhjetë (50) Euro**, të gjitha në afat prej **tridhjetë (30) ditëve**, nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan – DKR kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale sipas parashkrimit faktik dhe cilësimit juridik si në aktakuzën lëndore.

Kryetari i trupit gjykues sipas radhës ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, duke i ftuar palët sipas aktit akuzues. Në seancë janë paraqitur palët duke përfshirë edhe mbrojtësin e autorizuar av. Afrim Salihu nga Gjiilani.

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar në kuptim të nenit 246 të KPP-s kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij, ndër të tjera edhe për favoret edhe për pasojat e pranimin të fajësisë, i pandehuri me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij profesional shprehimisht ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në ngarkesë. Mbrojtësi i të pandehurit si dhe prokurori i shtetit nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me arsyetim se në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme për mbështetjen e kësaj akuze.

Kryetari i trupit gjykues pasi që ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-s me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e pasi që të njëjtin nuk e kanë kundërshtuar palët, ka vazhduar seancën e shqyrtimit fillestar me prezentimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga palët si në vijim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se gjykata gjatë matjes së dënimit duhet t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe sjelljen korrekte gjatë gjitha fazave të procedurës.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Afrim Salihu ka deklaruar se me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata duhet t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, pendimin e sinqert, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se është i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, dhe se i njëjti ka gjendje jo të mirë ekonomike. I njëjti e ka njoftuar gjykatën se në Prokurori ka paraqitur kërkesë për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, mirëpo meqë prokurori I çështjes penale Arben Ismajli tanimë ka kaluar në Këshill Prokurorial në Prishtinë pa autorizim për të proceduar lëndët më tutje, kjo çështje ka mbetë pa u përfunduar, mirëpo është i mendimit që për hir të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës penale kjo lëndë të zgjidhet edhe në formën tjetër lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij.

I pandehuri H. H. ka deklaruar se e mbështet deklaratën e mbrojtësit të tij duke u zotuar se në të ardhmen do të jetë i kujdeshëm që të mos përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme.

Kryetari i trupit gjykues me qëllim që mos ta mbështesë aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë së të pandehurit, në kuptim të nenit 361 të KPP ka vlerësuar edhe provat tjera në shkresa të lëndës e të bashkëngjitura aktit akuzues, të cilave jua ka falur besimin e plotë dhe ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këto çështje penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e shpallur fajtor të pandehurin për veprën penale lëndore dhe dënuar sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të gjitha elementet objektive lidhur me veprën penale lëndore, tani më janë jo kontestuese duke përfshirë edhe elementin subjektiv i cili konsiston në dashje direkte, pasi që ka mbajtur armën lëndore me fishekë në karrikator pa autorizim përkatësisht pa leje valide nga organi kompetent.

Sa i përket përgjegjësisë penale gjykata ka vërtetuar se në shkresa të lëndës nuk ka prova lidhur me mbështetjen e faktit relevant lidhur me atë se tek i pandehuri ka rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale ose se tek i njëjti ekziston aftësia esencialisht e zvogëluar, por as i pandehuri e as mbrojtësi i tij gjykatës nuk i kanë ofruar ndonjë provë në këtë drejtim, andaj edhe nga gjendja faktike e vërtetuar i pandehuri me vet faktin se ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tij kriminal duke pasur mundësi që t'i kontroll sjelljet e kriminale për t'i ju

shmangur posedimit të paautorizuar të armës lëndore, i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën penale lëndore.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar më lart, por edhe elementet objektive dhe subjektive lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri është kryes dhe penalisht përgjegjës i veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të gjykatës për llojin dhe lartësinë e dënimit, janë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese në kuptim të nenit 73 dhe 74 lidhur me nenin 75 paragrafi 12 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3. të KPRK-s, edhe atë: pranimin e fajësisë, pendimin e sinqert për veprimin e pamatur, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, gjendjen jot ë mire ekonomike të të pandehurit, se më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Mirëpo gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar si dhe rrethanat e lartcekura lehtësuese në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s është bindur se edhe me dënimin minimal prej 400 Eurove, mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, duke ndikuar në mënyrë rehabilituese dhe parandaluese ndaj të pandehurit por edhe ndaj qytetarëve potencial, duke i disiplinuar të njëjtit lidhur me respektimin e ligjit penal të vendit me të cilin në aspektin penal mbrohet siguria e të mirave juridike e qytetarëve dhe shtetit si tërësi.

Lidhur me dënimin plotësues gjykata ka vendos në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s, pasi që detyrimisht duhet konfiskuar objektin e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar i pandehuri në fjalë me pjesët tjera sin ë dispozitiv.

Pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët janë njoftuar me të drejtën në ankesë, por I pandehuri është njoftuar posaçrisht se mospagesa e dënimit me gjobë sjell zëvendësimin e këtij dënimi me dënim me burgim sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP kurse lidhur me kompensimin e viktimave të krimit ka vendos në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i krimeve të rënda
PKR.nr. 46/2019, më dt. 27 maj të vitit 2019**

**Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri**

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:082076
Datë: 28.05.2019
Numri i dokumentit: 00332270